



Nr i Protokolit 30
Me datën 24.02, 2025
Rahovec

Bazuar në nenin 80, nenin 81 dhe nenin 82 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 08/L-197, nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenin 4, nenin 5, nenin 6, nenin 7 dhe nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr. 30/2024 për procedurën e pranimit të nëpunësëve të shërbimit publik në sektorin e shëndetësisë dhe nenit 81.1 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, shpall këtë;

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të lira të punës:

I. Titulli i vendit të punës: Infermier/e

- Institucioni: QKMF "Dr. Fahredin Hoti" Rahovec
- Lloji i pozitës: Nënpunës i Shërbimit publik
- Numri i pozitave: 5 (pesë)
- Titulli i mbikqyrësit: Kryeinfermierit/eres, Drejtorit të QKMF-së
- Grada/koefficienti: H17 Koefficienti 5,9
- kohëzgjatja e emërimit: Në kohë të pacaktuar
- data e njoftimit: 24/02/2025

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zbaton dhe dokumenton kujdesin e pacientëve me kushte të sëmundjes sipas standardeve të punës;
- Zbaton procedurat dhe standarde në ofrimin e shërbimeve shëndetësore pa mbikqyrje
- Kujdeset për sigurinë e pacientit dhe monitorimin e vazhdueshëm të tij;
- Ndihmon në orientimin e punëtorëve të rinjë në punë dhe organizimin e punës për nxënësit dhe studentët në praktikë;
- Bashkëpunon me profile të tjera profesionale në menaxhimin e pacientëve;
- Bashkëpunon me punëtor nga njësitë tjera të institucionit;
- Rregullon, pastron dhe mirëmban hapsirën e punës, rrethinën e pacientit, paisjet instrumentet dhe mjetet tjera të punës;
- Trajton me kujdes racional dhe të saktë materialin, paisjet, mjetet dhe veglat e punës;
- Përgatit materialet dhe mjetet e punës për përdorim dhe intervenim;
- Kryen Vozitjen e Auto Ambulancës dhe Automjetit për Kujdesin Shtëpiak;
- Mbledh dhe proceson të dhëna të sakta mbi pacientin;
- Merr pjesë në aktivitetet e organizuara me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe informatave në mes të personelit shëndetësor;
- Ndihmon në lëvizjen dhe ngritjen e pacientëve të palëvizëshëm ose pjesërisht të lëvizëshëm;

- Pastron,dezinfekton,përgatit dhe ndihmon në kujdesin e pacientit;
- Menaxhon dokumentacionin mjekësor dhe largimin e tij nga njësia organizative ku punon;
- Kujdeset për dietën e pacientit;
- Kryen pune edhe detyra profesionale shëndetësore sipas lëmisë përkatëse profesionale infermierore.

K U S H T E T për Infermier të përgjithshëm i/e bachelor

- 1) Të jenë të kualifikuar (diplomë bachelor)
- 2) Të jetë i/e pajisur me licencën e punës
- 3) Patent Shofer Kategoria (B)
- 4) Çertifikatë mjekësore (pas përzgjedhjes nga Komisioni)
- 5) CV-ja
- 6) Kopja e letërnjoftimit
- 7) Vërtetimi nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetime
- 8) Vendi i punës (lokacioni) përcaktohet sipas nevojës.

Vlerësimi i kandidatëve:

- Testimi me shkrim (deri në 70 pikë) dhe
- Intervista me gojë (deri në 30 pikë)

Mënyra e aplikimit:

Dokumentacioni i aplikimit, dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në Zyrën e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në komunën e Rahovecit. Formulari i aplikimit merret /shkarkohet nga linku: <https://konkursi.rks-gov.net>. Dokumentacioni i pakompletuar dhe që arrin pas afatit të caktuar nuk do të merret në shqyrtim.

Themelimi i marrëdhënies së punës:

Marrëdhënia e punës themelohet vetëm nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës .

Aplikimi në konkurs:

Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 30 ditë nga data :25/02/2025 deri më 26/03/2025,ditëve të punës nga ora 08:00 deri në ora 16:00

Rahovec, 24.02.2025



Drejtoreshë e DSHPS-së

Saranda Sallteku
Saranda Sallteku